

VENDIM
Nr. 150, datë 27.2.2013

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË ADMINISTRATËS SË
AKADEMISË SË SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, gjithsej 29 veta, sipas lidhjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Vendimi nr. 399, datë 26.5.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha